



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

Datë: 26.08.2024
Ref: 106/2024

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit nr 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 (3.2), të Rregullores MF-NR- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, bazuar në Thirrjen publike të datës 02.08.2024, për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt propozimeve të OJQ-ve të publikuar nga Zyra e Kryeministrit/Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZH), nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm, sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike të datës 02.08.2024, për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt propozimeve të OJQ-ve, të shpallur nga KQPZH, duke u bazuar në Formularin 8 (Forma e mostrës për vlerësimin e kandidatëve për (vlerësues) anëtarë të komisionit vlerësues për ekspertet e jashtëm) si dhe nenin 8 paragrafi 3.2 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, (referuar tutje Komisioni) në këtë përbërje:

1.1. Kushtrim Gara	KQPZH/ZKM	Kryesues;
1.2. Xhavit Bulliqi	ZL/ZKM	Anëtar;
1.3. Safete Graiçevci	ZKGJ/ZKM	Anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë shqyrtimin, vlerësimin e të gjitha aplikacioneve dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm.

3. Komisioni përpilon listën e ekspertëve të jashtëm të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë anëtar të komisioneve vlerësuese për shqyrtimin dhe vlerësimin e Projekt/propozimeve të paraqitura nga OJQ-të sipas thirrjeve publike që do të bëjë Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZH).

4. Komisioni për punën e vet i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

5. Obligohet Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZH) dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arben KRASNIQI



U.d. Sekretari Përgjithshëm

Vendimi iu dërgohet:

- Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit;
- Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZH)
- Arkivit të Zyrës së Kryeministrit.